



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 306 Prot.

Datë 16.9.2019

Lënda: Treguesit e buxhetit të katër mujorit të II të vitit 2019 për institucionin AMSHC.

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE POLITIKAVE BUXHETORE

Tiranë

Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, të Ligjit Nr.99/2018, "Për Buxhetin e Vitit 2019"; të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit nr.22 datë 17.11.2016 "Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore", institucioni Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, raporton mbi treguesit e buxhetit të katër mujorit të dytë të vitit 2019.

Institucioni ka arritur objektivin e tij, mbështetjen financiare dhe monitorimin për projekte të OJF-ve sipas programeve të miratuara nga Bordi Mbikqyres i AMSHC-së nëpërmjet menaxhimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomik të burimeve.

Fondet buxhetore të akorduara për vitin 2019 janë në vlerën 124,000,000 lekë për shpenzime korrente dhe kapitale dhe 30,000 lekë fond i veçantë, të detajuara si:

në lekë	
EMËRTIMI	VITI 2019
Shp. Paga & Sig. Shoq.	16,500,000
Shp. të tjera korrente	106,530,000
Shp.kapitale të brendshme	1,000,000
Totali	124,030,000

Institucioni AMSHC, ka realizuar fondet buxhetore për katër mujorin e dytë të vitit 2019 në vlerën 96,913,283 lekë.

Fondi buxhetorë janë realizuar respektivisht si:

Artikulli "Paga" (600) është planifikuar në vlerën 13,800,000 lekë, realizuar 8,870,987 lekë.

Artikulli "Kontributi Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore" (601) është planifikuar në vlerën 2,700,000 leke, realizuar 1,459,603 lekë.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (artikulli 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM nr. 769, datë 15.07.2009 dhe VKM "Për përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të Përkohshme për vitin 2019 në njësitë e qeverisjes qendrore". Gjatë vitit 2019, numri mesatar i punonjësve është realizuar 15 punonjës faktik nga 16 punonjës të miratuar në strukturë, si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Artikulli "Mallra dhe Shërbime" (602) është planifikuar në vlerën 5,500,000 lekë, realizuar 2,915,285 lekë.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me:

- Realizimin e shpenzimeve të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e blerjeve dhe prokurimeve të mallrave dhe shërbimeve me të tretë për nevoja të AMSHC.
- Krijimin e facilitetit për udhëtime pune brenda dhe jashtë vendit me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit, rritjen e bashkëpunimit me OJF-të, me organizatat e shoqërisë civile si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Artikulli "Transferime Korrente të Brendshme" (604), është planifikuar në vlerën 101,000,000 lekë, realizuar 83,049,919 lekë.

Ky është dhe zëri me më peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC-së, duke qenë se dhe misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF-ve përfituese si dhe mbështetjen teknike të OSHC-ve në vend.

Në realizimin e këtij zëri, AMSHC-ja ka vazhduar me monitorimin dhe disbursimet e mbetura të Thirrjes 11 dhe është disbursuar kësti i parë i projekteve të Thirrjes Nr.12. Nga ana e Institucionit AMSHC janë zhvilluar dhe vijonë të zhvillohen konsultime me shoqërinë civile me objekt "Për realizimin e seancave të prezantimit, informimit dhe konsultimit mbi shpalljen e thirrjes së radhës për financim me grant të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", "Për realizimin e seancave të prezantimit, informimit dhe konsultimit mbi përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", "Takimet e parashikuara për prezantim të masave anti-korrupsion" etj. Gjatë vitit 2019 janë paraqitur 161 projekte nga organizatat OJF, ku AMSHC mbështeti financiarisht 52 prej tyre, në zbatim të prioriteteve të qeverisë në të mirë të interesit publik dhe fondit të miratuar për disbursimin e këtyre projekteve.

Artikulli "Transferta për Buxh. Fam & Individ" (606), është miratuar fond për shpërblim për dalje nëpunësi në pension në vlerën 30,000 lekë, realizuar 23,369 lekë për shpërblim për dalje në pension punonjësi.

Artikulli "Investime" (231) është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë, realizuar 594,120 lekë për blerje pajisje dhe derë të blinduar.

Në realizimin e zërave buxhetore të planifikuar për Vitin 2019, AMSHC ka zbatuar me korrektësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 10093, datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislacionin administrativo-financiar në fuqi.

DREJTOR EKZEKUTIV

Andi KANANAJ

Konceptoi : Mimoza Datja

Përgj. Sek. të Financës&Kontrollit të Brendshëm

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

Emri i Grupit		AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE						Kodi i Grupit	16
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit							
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti 4 mujori II 2019	Fakti 4 mujori II Viti 2019	Diferenca	
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2018	Viti 2019	Plan Fillestar Viti 2019	Plan i Rishikuar Viti 2019	Plani i Periudhes/progresiv	i Periudhes/progresiv		
0001	Planifikim menaxhimi	118,674	124,000	124,000	124,030	114,124	96,913	-17,210.7	
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		118,674	124,000	124,000	124,030	114,124	96,913	-17,211	
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit									
Totali		118,674	124,000	124,000	124,030	114,124	96,913	-17,211	

Drejtor Ekzekutiv	Emri	Andi Kananaj
	Firma	
	Data	



ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Shpenzimeve"


Njesia Shpenzuese - AMSHC

1088001

ne 000/leke

Emri i Grupit	AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE						Kodi i Grupit	16
Programi	Planifikim menaxhimi						Kodi i Programit	01110
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2018	(2) PBA Plan 2019	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2019	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2019	(5) Buxheti 4 mujori II 2019 Plani i Periudhes/progresiv	(6) Fakti 4 mujori II Viti 2019 i Periudhes/progresiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
600	Paga	13,275	13,800	13,800	13,800	9,722	8,871	-851
601	Sigurime Shoqërore	2,195	2,700	2,700	2,700	1,902	1,460	-443
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,830	5,500	5,500	5,500	5,240	2,915	-2,325
603	Subvencione							0
604	Transferta Korente të Brendshme	98,960	101,000	101,000	101,000	96,230	83,050	-13,180
605	Transferta Korente të Huaja							0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	47			30	30	23	-7
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	118,307	123,000	123,000	123,030	113,124	96,319	-16,805
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara							0
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara							0
231	Kapitale të Trupëzuara	366	1,000	1,000	1,000	1,000	594	-406
232	Transferta Kapitale							0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	366	1,000	1,000	1,000	1,000	594	-406
Totali	Shpenzime Kapitale	366	1,000	1,000	1,000	1,000	594	-406
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							0.0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		118,674	124,000	124,000	124,030	114,124	96,913	-17,211

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Drejtor Ekzekutiv	Emri	Andi Kanana
	Firma		Firma	
	Data		Data	



ANEKSI nr.3 "Raporti permbledhes i realizimit te treguesve te performances/produkteve te programit"

Emri i Grupit	AGJENCIA PER MBESHTETJEN E SHQPERISE CIVILE	Kodi i Grupit	88
Programi	Planifikim menaxhimi (AMSHC)	Kodi i Programit	01110

Programi	Planifikim menaxhimi (AMSHC)	Roba Programi	Shpenzimet	1088001												Luhatjet ne Koston per Njesi			Komente	
Njesia Shpenzuese Inspektoriati Kombetar i Mbrojtjes se Kombetar ne 000/leke				I		II		III		IV		V = IV - I			V = IV - II			V = IV - III		
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia matese	Sasia Faktike 2018 (sipas vitit paraardhes)	Shpenzimet 2018 (sipas vitit paraardhes)	Kosto per Njesi (sipas vitit paraardhes)	Sasia 2019 (sipas planit te vitit korent)	Shpenzimet 2019 (sipas planit te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te vitit korent)	Sasia (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Shpenzimet (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Kosto per Njesi (sipas planit te rishikuar te vitit korent)	Sasia Faktike kater mujori II vitit 2019	Shpenzimet Faktike kater mujori II vitit 2019	Kosto per Njesi Faktike (ne fund te vitit korent)						
A	Projekte te financuara nga AMSHC- ja	Numri i projekteve te financuara	45	116,758	2,595	60	121,280	2,021	60	121,280	2,021	52	95,639	1,839	-755	-182	-182	Krijuar produkte te reja thirja 12		
B	Monitorime/inspektime ne terren te projekteve te financuara	Numer monitorimesh/inspektimesh te kryera	45	1,915	43	60	2,750	46	60	2,750	46	52	1,274	24	-18	-21	-21	Monitoruar produkte te reja thirja 12		

Treguesit e Performances/Produktet e realizuara nga perdorimi i te ardhurave jashte limitit				
Kodi	Emertimi i Treguesit te Performances/Produktit	Njesia Matese	Sasia e realizuar	Fakti i peruludhes/progresiv
A	Produkti			0.0
D	Treguesi i Performances			0.0

Drejtuessi i Ekspit Menaxhues te Programit	Emri		Drejtor Ekzekutiv	Emri	Andi Kanari
	Firma			Firma	
	Data			Data	



ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit te objektivave te politikës se programit"

Periodha e Raportimit: Viti 2018

Kodi i Programit	01110	Emertimi i programit:	Planifikim menaxhimi (AMSHC)						Komente
Qellimi 1	Të sigurohen dhe të realizohen veprimtari në të mirë e në interes të publikut. Të vlerësohen organizatat e shoqërisë civile në bazë të aftësisë së tyre, përputhshmërisë së projektpropozimit me qëllimin e programit, efektshmërisë së veprimtarisë së tyre në lidhje me rezultatit e realizimit të aktiviteteve dhe të kostove të tyre.								
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit 2018	Niveli i planifikuar ne vitin 2019	Niveli i rishikuar ne vitin 2019	Niveli faktik i vitit 2019	% e realizimit te Treguesit te Performances/P roduktit	
Objektivi 1	Financimi i projekteve të propozuara nga OJF-të, të vlerësuara në përputhshmërinë e politikave publike në të mirë të interesit publik	Tregues 1	Emërtimi i Treguesit 1 Numri i projekteve të ofruara nga OJF-ve në të mirë të interesit publik, të cilat financohen nga institucionit AMSHC	45	60	60	52		
		Tregues 2	Emërtimi i Treguesit 2 Numri i projekteve të miratuara, të cilat kanë si qëllim fuqizimin e shtetit të së drejtës, luftën ndaj korrupsionit, rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve dhe vendimarrje lokale, në avokatinë për nisma ligjore, proceset e integritetit europian	6	21	21	19		
		Tregues 3	Emërtimi i Treguesit 3 Numri projekteve të miratuara, të cilat synojnë mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare, rehabilitimi i mjedisit dhe zhvillimi i turizmit	7	14	14	14		
		Tregues 4	Emërtimi i Treguesit 4 Numri projekteve qe synojnë fuqizimin e kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile	32	25	25	19		
		Tregues 5	Emertimi i Treguesit 5 Numri i takimeve informuese/ konsultative, trajnimeve, workshopeve dhe monitorimeve të	45	60	60	30		

* Objektivat e listuar janë në funksion të përbushjes së qëllimit të mesipër të politikës. Nëse specifikohet me shumë se 1 Qëllim, ai se bashku me objektivat e tij (psh Qëllimi 2 me Objektivi 2.1; 2.2; etj) duhet të futet në një tabelë tjetër të ngjashme, në vazhdim të kësaj.

** Si tregues për vlerësimin e performancës së objektivave, krahas produkteve, shërbejnë edhe tregues të tjerë të matshëm të lidhur me to. Këto mund të jenë standarte të njohura të fushës; tregues statistikorë; indekse kombëtare e ndërkombëtare, etj.

*** Ketu listohen të gjithë treguesit e performancës, përfshi dhe produktet. Raportimi për produktet bëhet periodik dhe vjetor, ndërsa raportimi për treguesit e performancës mund të bëhet edhe vetëm vjetor, nëqë matshmeria e tyre periodike paraqet vështirësi objektive.

Njëkohësisht, për ata tregues performance të cilët nuk vlerësohen mbi bazë vjetore por disa vjetore (psh vlerësime ndërkombetare të tilla si: OBI, PISA score, PEFA score, etc), si nivel i vitit paraardhës vendoset niveli me i fundit i regjistruar për ta.

Drejtesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Drejtor Ekzekutiv	Emri	Andi Kanaraj
	Firma			Firma	
	Data			Data	



ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"

Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)

Planifikim menaxhimi (AMSHC)

1088001

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2019 Kontraktuar	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (Viti 2019)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
M880001	Pajisje	700	2019	2019		700	366	366	366	
M880007	Dere e blinduar	300	2019	2019		300	228	228	228	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti _____ Kontraktuar	Plani i buxhetit viti _____	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente

Drejtuksi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri		Drejtor Ekzekutiv	Emri	
	Firma			Firma	
	Data			Data	

